REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM
Nr. 8, datë 27.02.2026

"PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR NDIHMËN EKONOMIKE DERI NË 6 % PËR MUAJIN JANAR 2026"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9, neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike" ,Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.868 datë 29.12.2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 597 datë 04.09.2019", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.617 datë 22.09.2022, Udhëzimi i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr.5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok- ndihmën ekonomike deri në 6 për qind" , Vendimi i Këshillit të Bashkisë Nr. 6 datë 30.01.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor", me propozim të Drejtorisë së Kujdesit Social, Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e paraqitur:

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 për qind dhe trajtimin ne total 20 (njëzetë) familje me një fond prej 75.027(shtatëdhjetë e pesë mijë e njëze e shtatë) lekë dhe konkretisht:

a. Për Bashkinë Sarandë 19 (nëntëmbëdhjetë) familje me një fond 69.146(gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëqindë e dyzetë e gjashtë) lekë, lekë sipas listës nr.1 bashkëlidhur.
b. Për Njësinë Administrative Ksamil 1 familje me nje fond 5.881(pesëmijë e tetëqindë e tetëdhjetë e një) lekë, sipas listës nr.2 bashkëlidhur.

2. Ngarkohen Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM
Nr.9, datë27.02.2026

"MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA TË ARDHURAT E BASHKISË PËR MUAJIN JANAR 2026"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9, neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë ", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597 datë 04.09.2019 "Përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë Nr 6 date 30.01.2025 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si dhe nga fondet e buxhetit vendor", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë nr.73 datë 23.12.2024 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2025" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e paraqitur:

V E N D O S I:

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike dhe mbështetje financiare nga të ardhurat e Bashkisë Sarandë për muajin Janar 2026, në total për Bashkinë Sarandë dhe Njesinë Administrative Ksamil 57 familje me një fond 258.834 (dyqind e pesëdhjetë e tetëmijë e teëqindë e tridhjetë e katër) lekë dhe konkretisht:

Nr.	Njësitë Administrative	Nr.i familjeve	Shuma në lekë
1	Qendra e Bashkisë Sarandë	45	192.504
2	Njesia Administrative Ksamil	12	66.330

Familjet që do të përfitojnë në skemën e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Janar janë sipas listës bashkëlidhur.

Të mos trajtohen me ndihmë ekonomike familjet si më poshtë:

Qendra e Bashkisë Sarandë

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Arsyet e daljes nga skema
1	Leni Filip Dhrami	Perfiton nga skema 6% e bllokskemës së NE
2	Sulltana Halim Sulka	Perfiton nga skema 6% e bllokskemës së NE

3	Agapi Ali Rustemi	Perfiton nga skema 6% e bllokskemës së NE
4	Hanko Koçi Kordha	Perfiton nga skema 6% e bllokskemës së NE
5	Mariana Koçi Bubuçi	Perfiton nga skema 6% e bllokskemës së NE

Të trajtohen për herë të parë me skemën e ndihmës nga të ardhurat

Qëndra e Bashkisë Sarandë

Trajtohet per herë te parë 1 familje

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Arsyet e hyrjes në skemë
1	Nimete Habip Çukori	Kryefamiljare grua , moshe pensioni pa pension

Qëndra e Njësisë Administrative Ksamil

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Arsyet e hyrjes në skemë
1	Dafina Ali Pana	Kryefamiljare grua, e ve, me dy fëmijë

Rifuten në skemën e ndihmës ekonomike në Bashkisë Sarandë 8(tetë) familje:

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Arsyet e hyrjes në skemë
1	Faike Hysen Delilaj	Kryefamiljare grua, te ardhura te pamjaftueshme, pensioniste
2	Luljeta Ilmas Jaho	Kryefamiljare grua, te ardhura te pamjaftueshme, pensioniste
3	Vito Xhevid Beduli	Kryefamiljare grua, te ardhura te pamjaftueshme, pensioniste
4	Polina llesh Marku	Kryefamiljare grua, te ardhura te pamjaftueshme, prag pensioni
5	Antigoni Çoban Goxhaj	Viktime e dhunës në mardhëniet familjare
6	S.S.Goxhaj	Viktime e dhunës në mardhëniet familjare

7	Xhesiana Artan Skëndi	Viktime e dhunës në marrëdhëniet familjare
8	Maria Arben Zenuni	Kryefamiljare grua, ekstremisht e varfër, ne proces divorci

2. Ngarkohen Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr.10, datë27.02.2026

"PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR FINANCIM PËR PROJEKT-PROPOZIMIN "OFRIMI I SHËRBIMIT "PAK PËRTEJ DISTANCËS"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Neni 24, ligjit Nr 121/2016 " Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 224 datë 9.04.2024 "Për metodologjinë e llogaritjers së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror", Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 102 datë 29.08.2025 "Për miratimin e Planit Social 2026-2028" ,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kërkesën për financim për projekt-propozimin "Shërbimin e lëvizshëm "PAK përtej distancës" i parashikuar në planin social 2026-2028 të Bashkisë Sarandë, në Objektivin 3.2 në planin e aktiviteteve të planit të miratuar.
2. Efektet financiare do të përballohen nga fondi social i dedikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale e cila do të mbështesë projektin në vitin e parë me 90% të kostos totale, në vitin e dytë me 60% të kostos totale dhe në vitin e tretë dhe në vazhdim me 30% të kostos totale.
3. Efektet financiare në buxheti vjetor të Bashkisë Sarandë do të jenë në vitin e parë me 10% të kostos totale , në vitin e dytë me 40% të kostos totale dhe në vitin e tretë dhe në vazhdim me 70% të kostos totale.
4. Ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social për vijimin e aplikimeve pranë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqënien Sociale duke respektuar afatet ligjore të përcaktuara në thirjen përkatëse të ministrisë.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr.11, datë 27.02.2026

"PËR MIRATIMIN E SHTETASES V.P PËR T'U TRAJTUAR NË QENDRËN POLIVALENTE DITORE TË TË MOSHUARVE "FETI RUGJI" SARANDË"

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" neni 9 , neni 24 , Ligjit Nr 57/2019 "Për asistencen sociale në Republikën e Shqipërisë ", Ligjin nr.121/2016 ''Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë'' neni 28, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.518 date 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar" , Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë nr.73 datë 23.12.2024 "Për miratimin e detajimit të buxheTit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë Sarandë "dhe relacionin e Komisionit Multidisiplinar të Vlerësimit të Rasteve në Nevojë , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e paraqitur:

V E N D O S I:

1. Të trajtohen në Qendrën Polivalente Ditore të të moshuarve "Feti Rugji", të moshuares e vetmuar Znj.*Vanthia Papa*, në moshë pensioni, me vështirësi ekonomiko-sociale dhe e aftë për jetë kolektive.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social dhe Qendra Polivante e të Moshuarve "Feti Rugji".
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDE

PROJEKT-VENDIM

Nr.12, datë27.02.2026

"PËR MIRATIMIN E DRAFT MARRËVESHJES SË BINJAKËZIMIT NDËRMJET BASHKISË SARANDË , SHQIPËRI DHE BASHKISË SË PARDUBICËS, ÇEKI"

Mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 9, të drejtat dhe përgjegjësitë, pika 1.5. "Të drejtën e bashkëpunimit", paragrafi b) bashkëpunojmë me njësi të vetëqeverisjes vendore të vendeve të tjera dhe përfaqësohen në organizata ndërkombëtare të pushteteve vendore, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi, si dhe VKM nr. 734, datë 09.09.2015, "Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore", pikat 9 dhe 11/c, Këshillit Bashkiak pas shqyrtimit të Relacionit të Drejtorisë së Projekteve, Turizmit dhe Integrimit Europian,

VENDOSI:

1. Miratimi në parim i draft marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Sarandë , Shqipëri dhe Bashkisë së Pardubicës ,Çeki sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Z.Oltion ÇAÇI, për lidhjen e marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet Bashkisë Sarandë, Shqipëri dhe Bashkisë së Pardubices, Çeki.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Sarandë dhe Drejtorisë së Projekteve, Turizmit dhe Integrimit Europian
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SARANDË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr. 13 datë 27.02.2026

"PËR MIRATIMIN E NISJES SË PROCEDURËS DHE MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PËR PASURITË PRONË PRIVATE , QË PREKEN NGA PROJEKTI "POLI I ZHVILLIMIT TURISTIK SARANDË "

Në mbështetje të nenit 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9, pika 1.2/b të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për neintere interes publik", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.71 datë 30.05.2025 "Për miratimin marrëveshjes së bashkëinvestimit ndërmjet fondit shqiptar të zhvillimit dhe bashkisë sarandë me objekt: "Projektimi, ndërtimi, administrimi dhe menaxhimi i qëndrueshëm i projektit "Poli i Zhvillimit Turistik në Sarandë", Këshilli i Bashkisë Sarandë,

VENDOSI:

1. Të miratojë nisjen e procedurës së shpronësimit dhe miratimin në parim vlerën financiare të shpronësimit prej *39.324.548 ,14 (tridhjetë e nëntë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë katërmbëdhjetë)* lekë , për pasuritë pronë private , sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës , i ngarkuar për kryerjen e e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimit, që preken nga investimi publik me objekt: " Poli i zhvillimit turistik në Sarandë" .
2. Fondi i shpronësimit me vlerë *39.324.548 ,14 (tridhjetë e nëntë milion e treqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e dyzet e tetë pikë katërmbëdhjetë)* lekë do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Sarandë. Lëvrimi i fondit do të kryhet pasi të jetë botuar VKM-ja për shpronësim.
3. Ngarkohet Drejtoria e Financës,Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimi të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Në mungesë dhe me porosi
ZV/KRYETAR
Elton DAUTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr.14, datë 27.02.2026

"PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.20 DATË 16.05.2017 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE"

Në mbështetje të ligjit 44/2015 " Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.8308 datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" i ndryshuar , Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.325 datë 19.03.2008 "Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e subjektit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve , si dhe njohjen e dokumentave zyrtare , të caktuara për këta subjekte" I ndryshuar, Udhëzimi nr. 5627 datë 18.11.2016 "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", Udhëzimin nr.15 datë 24.07.2007 "Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimarisë në transportin rrugor" i ndryshuar, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.20 datë 16.06.2017 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së trasportit taksi të udhëtarëve" ndryshuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.7 datë 28.01.2022 "Për disa ndryshime në VKB nr.20 datë 16.06.2017", Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 19 datë 16.05.2017 "Për miratimin e linjave qytetëse dhe rrethqytëse",

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në vendimin nr.20 datë 16.05.2017 "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë së trasportit taksi të udhëtarëve, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

Në nenin 7, shtohet gërma 'h', me përmbajtjen si më poshtë:

h)*Të plotësojë kërkesat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi duke paraqitur dokumentacionin provues sipas formularëve të aplikimit sipas akteve që miratohen nga Kryetari i Bashkisë.*

Në nenin 8, shtohet gërma 'g', me përmbajtjen si më poshtë:

g) *Të plotësojë kërkesat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi duke paraqitur dokumentacionin provues sipas formularëve të aplikimit sipas akteve që miratohen nga Kryetari i Bashkisë.*

Neni 12 ndryshe si më poshtë:

Drejtuesi i taksisë , në rast të ndërprerjes së veprimtarisë të parashikuara në nenin 9 dhe në rast të pezullimit të aktivitetit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit mbartë detyrimin për njoftimin e Bashkisë Sarandë , si dhe të kthejë lejen për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

Në nenin 33 ndryshohet si më poshtë:

Drejtuesi i mjetit taksi ndëshkohet për kundërvajtje administrative me gjobë deri në vlerën 20.0 000 (njëzet mijë) lekë, kur:
a) ushtron transportin taksi të udhëtarëve në kundërshtim me dispozitat e nenit 15 të kësaj rregulloreje;
b) nuk gjendet pranë automjetit të tij gjatë qëndrimit në vendqëndrim dhe/ose nuk e vendos automjetin sipas radhës së përcaktuar, në përputhje me nenin 20, paragrafët 1 dhe 2;
c) ofron shërbimin e transportit taksi jashtë vendqëndrimit të miratuar për automjetet taksi, në kundërshtim me nenin 20, paragrafi 3;
d) vepron në kundërshtim me nenin 20, paragrafi 5 dhe nenin 21 të kësaj rregulloreje;
e) nuk aktivizon taksimetrin në momentin e nisjes në automjet;
f) nuk realizon transportin e udhëtarit sipas itinerarit të përcaktuar prej tij, përfshirë mosndjekjen e rrugës më të shkurtër, në kundërshtim me nenin 24;
g) kërkon ose arkëton pagesë më të lartë se tarifa e shënuar nga taksimetri, në kundërshtim me nenin 26;
h) vepron në kundërshtim me nenin 29 të kësaj rregulloreje.
2. Në rast se konstatohet se subjekti i licensuar është përsëritës në rastin e pikës e , të meret masa për heqjen e liçensës së veprimtarisë taksi.
3.Në rastet e ushtrimit të veprimtarisë së transportit taksi në kundërshtim me kushtet e licencës, përveç masës administrative të gjobës, zbatohet edhe masa administrative plotësuese e tërheqjes së licencës.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr.15, datë 27.02.2026

"PËR MIRATIMIN E NIVELIT TE PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVE TË BASHKISË SARANDË DHE NJËSIVE NË VARËSI"

Në mbështetje të nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja "b", nenit 54 shkronja "ç", nenit 55, pika 2, të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore", Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligji nr.35/2023" Për kompetencat për caktimin e pagave ,trajnimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të punësuarve në institucionet e administratës publike , si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi",Vendimit të Këshillit të Ministrave Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.328, datë 31.05.2023 "Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur, të emëruar, të nëpunesve civile e të punonjësve administrativë të njësisë së vetëqeverisjes vendore" të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 503 datë 01.08.2024 „Për disa ndryshime në vendimin nr.328, datë 31.05.2023 "Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur, të emëruar, të nëpunesve civile e të punonjësve administrativë të njësisë së vetëqeverisjes vendore, te ndryshuar, me "Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 103 datë 11.02.2026 "Për disa ndryshime në vendimin nr.328, datë 31.05.2023 "Për grupimin e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur, të emëruar, të nëpunesve civile e të punonjësve administrativë të njësisë së vetëqeverisjes vendore" Vendim te Keshillit te Ministrave nr 87 datë 06.02.2026 per " disa ndryshuime ne Vendimin nr 326 date 31.05.2023 te Keshillit te Ministrave " Për pagat e punonjësve mbeshtetes dhe punonjesve te tjere te specialiteteve te ndryshme ne disa institucione te administrates publike" te ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit Bashkiak të Sarandës nr.151 datë 23.12.2026 " Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2026", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pasi analizoi relacionin e paraqitur:

V E N D O S I:

1. Miratimin e nivelit të pagave për funksionarët, nëpunësit civilë, punonjësit administrativë të Bashkisë së Sarandes sipas lidhjeve nr.1 dhe 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e shpërblimit mujor të këshilltarëve të Këshillit Bashkiak të Sarandës , në masën 10 % të pagës mujore të Kryetarit të Bashkisë.
3. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Janar 2026 dhe për zbatimin e pikës 1 do të përballohen nga "*Të ardhurat e Bashkisë*"nga zeri *"Të paperdorura nga viti 2025".*
4. Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.44 datë 30.08.2024 "Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar , të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Bashkisë Sarandë dhe njësive të varësisë" , si dhe çdo vendim tjetër që vjen në kundërshtim me parashikimet e këtij vendimi , shfuqizohen.
5. Ngarkohen Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Personelit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Në mungesë dhe me porosi
ZV/KRYETAR
Elton DAUTI